



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova
Komuna e Novobërdës
Opština Novo Brdo - Municipality of Novo Brdo

KUVENDI KOMUNAL-SKUPSTINA OPSTINE- MUNICIPAL ASSEMBLY

Anëtarit të Komitetit për Politikë dhe Financa
Z/znj _____

Në bazë të dispozitave të nenit 52 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale si dhe në bazë të dispozitave të nenit 41 të Statutit të Komunës së Novobërdës.

F T O J

Mbledhjen e nëntë të Komitetit për Politikë dhe Financa e cila do të mbahet më 19.11.2018 (e hënë) duke filluar në ora 10:00.

Rendi i ditës

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KPF-së;
2. Raporti i DUK-së për punën e deritanishme të komisionit për emrimin e rrugëve në teritorin e Komunës së Novobërdës;
3. Shqyrtimi i kërkesës së parashtruar nga ana e disa fermereve të Komunës së Novobërdës për lirim nga pagesa e lejes së ndërtimit të shtallave;
4. Raportim rreth ndarjes të ndihmes financiare në vlerë prej 5,000€ për fermerët e dëmtuar nga vjedhjet të Komunës së Novobërdës, (në bazë të kërkesës së komitetit për komunitete);
5. Shqyrtimi i propozim rregullores mbi tatimin në pronë për vitin 2019;
6. Të ndryshme.

Mbledhja do të mbahet në hapësirat e K.K-së në Novobërdë.

Më: 14.11.2018
Në: Novobërdë



Kryesues i Kuvendit
Nebojsa Arsic

(Signature)



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosova
Komuna e Novobërdës
Opština Novo Brdo–Municipality of Novo Brdo

KUVENDI KOMUNAL-SKUPSTINA OPSTINE- MUNICIPAL ASSEMBLY

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e tetë e Komitetit për Politikë dhe Financa e mbajtur më 22.10.2018, duke filluar në orën 10:00. Në mbledhje kanë marrë pjesë: Anëtarët e KPF-së: Nebojsa Arsic, Xhejlane Behluli, Milica Jovanovic, Selatin Nuhiu, Mirjana Simijonovic, Drejtori i Financave Sercan Todorovic, Drejtori i Administrates Driton Abdyli, Zyrtari i Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik Driton Mustafa, shefi i kabinetit të zyres së Kryetarit Sinisa Markovic dhe përfaqësuesi i OSBE-së.

Kryesuesi pasi përshëndeti të pranishmit tha: para se të fillojmë me punën e KPF-së dhe rendin e ditës duhet konstatuar korumin prezentë janë të gjithë antarët e KPF-së, kemi korumin për punë pas kësaj e hapi mbledhjen me këtë:

Rend dite

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KPF-së;
2. Raporti i komisionit mbi emrimin e rrugve në teritorin e komunës së Novobërdës;
3. Vendosja e mbishkrimeve në ndërtesën e Komunës dhe hapsirave zyrtare;
4. Zgjedhja e komisionit për ndrimin e statutit;
5. Raporti finaciarë për periudhën tre mujore 2018 (Korik-Shtatorë).
6. Të ndryshme.

Kryesuesi i pyeti të pranishmit a pajtohen me këtë rend dite apo keni ndonjë propozim?
Selatin Nuhiu pasi përshëndeti të pranishmit tha: e kam një propozim për rend dite që të shtohet edhe një pikë shtesë në rend ditë. Kisha kërku që për Kuvend të kemi raportin e Drejtorisë së Arsimit për fillimin e vitit të ri shkollorë për vitin 2018/19.

Kryesuesi tha: pikë plotësim për rend dite kemi Raportin e Drejtorisë së Arsimit për vitin 2018/19;

Kush është për aprovim të rendit të ditës më këtë pikë të propozuar?

Pasi nuk pat propozime tjera rendi i ditës u aprovua njëzëri nga të gjithë anëtarët prezent të KPF-së më këtë pikë shtesë të propozuar: Raportin e Drejtorisë së Arsimit për fillimin e vitit të ri shkollorë për vitin 2018/19;

Pika e parë: Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KPF-së;

Kryesuesi e hapi diskutimin për këtë pikë.

Milica Jovanovic pasi përshëndeti të pranishmit tha: kur kemi diskutuar për projektet e kam propozuar një rrugë për fshatin Gosalc dhe nuk është paraqitur në procesverbal

Pasi nuk pat vërejtje tjera u aprovua njëzëri procesverbali më këtë vërejtje.

Pika e dytë: Raporti i komisionit mbi emrimin e rrugëve në teritorin e Komunës së Novobërdës;

Kryesuesi tha: pasi që prezantuesi i kësaj pike nuk është prezent votojmë që ta shtyjmë këtë pikë për ndonjë mbledhje të ardhshme.

Kjo pikë u votua njëzëri nga të gjithë antarët e KPF-së që të shtyhet për mbledhje tjera.

Pika e tretë: Vendosja e mbishkrimeve në ndërtesën e Komunës dhe hapsirave zyrtare;
Për këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit ja dha fjalën Drejtorit të Administrates Driton Abdyli.

Driton Abdyli pasi përshëndeti të pranishmit tha: kjo pikë është kërkesë që të shkoj në Kuvend, është kërkesë nga Kryetari i Komunës me qëllim që të diskutohet dhe të mirret mendimi edhe i antarëve të KPF-ës dhe Kuvendit për vendosje të këtyre mbishkrimeve të reja në hapsirën e objektit të Komunës. Këto mbishkrime në dyert e zyreve ku përfshihet edhe mbishkrimi në hyrje të Komunës sipas disa informacioneve që unë i kam janë të shtypura nga një projekt i Komunës me USAID në mandatin e kaluar, natyrisht vendosja e mbishkrimeve dhe gjërave tjera janë punë e Administrates por duke e marrë parasysh përbërjen etnike, për të mos pasur ndonjë keqkuptim në mes të komuniteteve Kryetari i Komunës ka menduar që këtë pikë kështu si është të dërgohet në Kuvend dhe antarët të kenë mundësi të diskutojnë dhe ti paraqesin sygjerimet dhe vërejtjet e tyre, po mendoj që nuk ka asgjë të keqe që kjo pikë të shkoj në Kuvend përkundrazi është më mirë që të shkoj në Kuvend se sa të vendosen mbishkrimet njëher e mandej të këtë reagime, si në KPF ashtu edhe në Kuvend secili e ka të drejtën e vet ti paraqes sygjerimet, plotësimet dhe meqenëse Kryetari e ka propozuar do ta përfill vendimin e Kuvendit në të ardhmen, më shumë nuk kam se çka të shtojë nese ka dikush ndonjë pyetje urdhëroni, ju faleminderit.

Kryesuesi e hapi diskutimin

Pasi nuk pat diskutime kjo pikë u votua njëzëri nga të gjithë antarët e KPF-së që të shkoj në Kuvend.

Pika e katërtë: Zgjedhja e komisionit për ndrimin e statutit;

Kryesuesi tha: para disa muajve kemi filluar me konsultime për ndrimin e statutit, ndoshta ky term nuk është i përshtatshëm por i kemi disa nene të cilat nuk janë në pajtueshmeri me Ligjin për Vetqeverisje Lokale për këtë arsye kemi kërkuar që të përmirësohet dhe të përshtatet me Ligjet në fuqi, p.sh e kemi formimin e KPF ku në statut thuhet se përbëhet prej 7 antarëve ndërsa në Ligj prej 5 antarëve për më shumë ja dha fjalën Drejtorit të Administrates që të na informoj.

Driton Abdyli tha: po ashtu edhe kjo pikë e rendit të ditës është propozuar nga Kryetari, më shumë për këtë pikë nuk kam se çka të shtojë përveç asaj që e that ju, tash për tash aq sa di ka të bëjë me disa përshtatje të pikave, neneve me ligjet në fuqi, ju ftoj ta votni që të shkoj në Kuvend pastaj aty do të formohet komisioni që do të punoj në statut mandej do të del edhe në debat publik, ju faleminderit.

Kryesuesi e hapi diskutimin për këtë pikë.

Xhejlane Behluli pasi përshëndeti të pranishmit tha: vetem e kam një pyetje për sqarim sa i përket këtij komisioni a do të jenë antarët prej Kryetarit dhe Kuvendit apo të emruar vetem prej Kryetarit.

Driton Abdyli tha: ndrimi i statut rrjedh prej tri iniciativave, është Kryetari i cili e propozon, Kuvendi me 2/3 e votave dhe janë 20% nënshkrimet e qytetarëve, nuk jam shumë i sigurt të perqindja po e di se edhe qytetarët me nënshkrime kanë të drejt të marrin iniciativë për ndrim të statutit.

Selatin Nuhui tha: sa i përket komisionit për ndrimin e statutit e kam një pyetje pasi që Drejtori i Financave është këtu a kanë parapa ata meditje për këtë komision?

Kryesuesi tha: mendoj se ky komision do të bëjë një punë voluminoze dhe nuk mundet të perfundojë shumë shpejtë, besoj që do të na ndihmojë edhe OSBE-ja edhe Ministria e Pushtetit Lokal dhe komisioni duhet të jetë i perzier prej egzekutivit dhe legjislativit.

Driton Abdyli tha: pasi Drejtoria e Financave nuk po pergjigjet, në statutin e kemi plotësuar në vitin 2010 dhe për komisione une e di që është një rregullore e brendshme e Komunës për këto komisione.

Pasi nuk pat diskutime tjera kjo pikë u votua njëzëri nga të gjithë antarët e KPF-ës që të shkoj në Kuvend.

Pika e pestë: Raporti finaciarë për periudhën tre mujore 2018 (Korik-Shtatorë).

Për këtë pikë Kryesuesi ja dha fjalën Drejtorit të Financave Sercan Todorovic.

Sercan Todorovic pasi përshëndeti të pranishmit tha: me material e kemi marrë raportin financiar për periudhën korrik shtator 2018, do ti paraqes disa të dhëna për këtë periudhë, e kemi të hyrat vetanake për tremujorshin e tretë të cilat në total janë 51,081.97€, me radh i kemi në tabel të hyrat nga tatimi në pronë 15,704.15€, të hyrat nga regjistrimi i automjeteve 5,150.00€ dhe të hyrat e tjera i kemi të paraqitura që mos ti ceki secilen veç e veç, në faqen tjetër e kemi tabelën e shpenzimeve për paga dhe meditje kanë qenë të planifikuara 472,360.50€ kurse janë shpenzuar 463,494.70€, për mallra dhe shërbime janë shpenzuar 51,054.62€, për shpenzime komunale janë shpenzuar 13,332.30€, për subvencione janë shpenzuar 2,516.50€ dhe për investime

kapitale janë shpenzuar 127,755.28€ i keni tabelat edhe për secilen zyre veç e veç unë kaq kisha nese keni ndonjë pyetje urdhëroni, ju faleminderit.

Kryesuesi e hapi diskutimin për këtë pikë.

Xhejlane Behluli tha: e kamë një vërejtje pasi që gjithmonë po më pengon drejtëshkrimi por kot dhe nuk po e kuptoj këtu një term pasi që nuk është përkthyer.

Driton Mustafa tha: është gabim teknik gjatë perkthimit.

Selatin Nuhiu tha: sa i përket buxhetit të këtij tremujori nuk po shfrytëzohet racional, te permbaruesi për këtë tremujor i kemi 13,510.58€ d.m.th 12% të investimeve kapitale janë marrë nga permbaruesi, kjo është përserit edhe në tremujorin e dytë nese mundet Drejtori të na sqaroj se pse nuk po paguhen fakturat ndaj operatorëve ekonomik, te blerja e kafshëve paret janë marr prej Drejtorisë së Financave ndërsa është duhur të mirren prej Subvencioneve dhe kjo mendoj se nuk është e drejtë.

Sercan Todorovic tha: i kemi pasur disa obligime prej vitit 2015 dhe në Stanishor kemi pasur problem sa i përket pagesave që janë kryer te permbaruesi privat.

Selatin Nuhiu tha: për mos me dyshu ne në pagesa duhet të na dërgohen informatat ne detale.

Pasi nuk pat diskutime tjera kjo pikë u votua njëzëri nga të gjithë antarët e KPF-ës që të shkoj në Kuvend.

Pika e gjashtë: Të ndryshme.

Kryesuesi e hapi diskutimin për këtë pikë.


Pasi nuk pati diskutime Kryesuesi i falemendëroi të pranishmit për pjesëmarrje.

Mbledhja përfundoi në orën 10:40

Procesëmbajtëse
Valmire Mustafa



Kryesues i Kuvendit
Nebojsa Arsic





Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova
Komuna e Novobërdës
Opština Novo Brdo - Municipality of Novo Brdo



Drejtoria e Kadastrit dhe Urbanizmit/Direkcija Urbanizma i Kadastra

Për/Za: Antarët e KPF-së - Clanove KPF-a

Nga/Od: Direktorata za Kadastra i Urbanizma
Direktor g. Bojan Peric

Me/Dana: 14.11.2018
Në/U: Novobërdë/Novo Brdo

Lënda/Predmet: Izvestaj o radu Komisije za imenovanje Ulica.

Të nderuar, Postovani,

Ju drejtohem Ju antarve të KPF-së, me qëllimin që tju informoj për punët e kryera deri më tani nga Komisijoni i Caktuar për Emrimin e rrugëve në teritorin e Komunës së Novobërdës.

Besoj se e dini se Unë jamë emmruar para një kohe në këtë pozitë, por kam kërkuar informata se deri ku është aritur me punë. Kam konstatuar se mbi 90% e punes ka përfunduar, e Unë ju premtoj se deri në fund të vitit ose më së largu deri në tre mujorin e parë të vitit të ardhshëm da ta përfundojmë dhe pas shqyrtimit adekuat dhe informimit si të KPF-së ashtu të Kuvendit do ti procesojmë edhe ne Ministrin kompetente dhe ti vazhdojmë më pas punët e mbetura.

Tani për tani nuk do të kisha më shumë të shtoj, pra qëllimi imë ishte tju informoj se si drejtori kemi filluar serizoishtë të miremi me këtë qëshhtë.

Ju falenderit, e nëse keni ndonjë pyetje do të provoj të Ju përgjigjem.

Obracam se Vama clanovima KPF-a, sa ciljem da vas informisem za završeni dosadasnji posao od strane Komisije za Imenovanje Ulica u teritoriji opštine Novo Brdo. Verujem da znate da sam Ja imenovan pre kratkog vremena, i traziosam informacije dokle se stiglo sa radom. Utvrdiosam da vise od 90% posla vec je završen, a Ja vam obecavam da do kraja godine ili naj kasnije do kraja prvog tromesecja naredne godine završicemo i ovaj deo i posl adekuatno da to razmatramo i u KPF-u i u Skupstinu, a poto proslediti u kompetentnom Ministarstvu i da posle završimo.

Zasad ne bih imao sta da dodam vise, pa moj cilj je bio samo da Vas informisem da mi kao direktorat ozbilno smo poceli da se bavimo ovim pitanjem.

Hvala sto ste me saslušali, i ako imate neko pitanje ja cu pokusati da Vas informisem.



Për: z. Svetislav Ivanovic, kryetar i Komunës së Novobërdës
CC: z. Bajrush Ymeri, nënkryetar i Komunës së Novobërdës
z. Nebojsa Arsiq, Kryesues i Kuvendit Komunal

Nga: Fermerët që kanë përfituar ndërtimin e fermave këtë vit nga ministria e bujqësisë

Lënda: Kërkesë

Të nderuar,

Ne fermerët që kemi përfituar ndërtimin e fermave nga ministria e bujqësisë kërkojmë nga ju që të na lironi nga pagesa e lejes së ndërtimit të fermave.

Këtë kërkesë e drejtojmë te ju për arsye se të gjitha komunat e në veçanti komunat e Anamoravës ka kohë që e kanë hjekur këtë pagesë për leje ndërtimore që ka të bëjë me bujqësinë në mënyrë që të ndihmohet zhvillimi i bujqësisë në teritorin e komunës sonë.

Me shpresë që kjo kërkesë e jona do të hasë në mirëkuptimin e juaj ne ju falemnderojmë paraprakisht.

Në Novobërdë
Më 05.10.2018

Fermerët:

1. Shabi Arifi

2. Srecko Peric

3. Nazmi Isufi

4. Sinisha Maksimovic